




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D   DPK
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No	01-3659/15
Data Datum Date	27.10.2015
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 27.10.2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbylllet rasti me Nr. AKK-03-02-2931-15 për z. Avni Hajrullahu – Kryeshef Ekzekutiv, N.P.L. “Stacioni i Autobusëve” Gjilan, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, meqë z. Hajrullahu ka heq dorë nga funksioni i personit të autorizuar në një biznes privat, duke shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-2931-15, për Zyrtarin e lartë, z. Avni Hajrullahu–Kryeshef Ekzekutiv, N.P.L. “Stacioni i Autobusëve” Gjilan, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Zyrtari i lartë, z. Hajrullahu është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korruptionit (ZD/DPK-01-3007/15), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korruptionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Hajrullahu, është deklaruar se do t'i bëjë ndryshimet e kërkua të Agjencionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korruptionit, ka sjell një shkresë përcjellëse (përgjigje) si dhe shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) “Informata mbi biznesin”(DPK/DPKI-03-02-3480/15), në të cilën shihet se z. Hajrullahu tashmë

ka heq dorë nga ushtrimi i funksionit të personit të autorizuar në biznesin; Shoqëri aksionare, "Wind Power" Sh.A. , me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

**II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

/ Hasan Preteni /

